



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Raporti i Auditimit të Pajtureshmërisë

**“Monitorimi i zbatimit të Skemës së
Granteve të Programit për Zhvillim
Rajonal të Balancuar” periudhën 2024-
2025**

HYRJE.....	2
SHKURTESA.....	3
PJESA I. PËRMBLEDHJA E PËRGJITHSHME	4
PJESA II. LËNDA E AUDITUAR DHE FUSHËVEPRIMI.....	5
I.1. TITULLI DHE ENTITETI I AUDITUAR.....	5
I.2. PERIUDHA E AUDITIMIT	5
I.3. ARSYESHMËRIA DHE BAZA LIGJORE PËR KRYERJEN E AUDITIMIT... 	6
I.4. STANDARDET E PËRDORURA TË AUDITIMIT	6
I.5. PËRSHKRIMI I LËNDËS SË AUDITIMIT DHE FUSHËVEPRIMIT TË AUDITIMIT	6
I.6. OBJEKTIVAT E AUDITIMIT	8
I.7. KRITERET E AUDITIMIT	8
PJESA III. GJETJET	9
1. Mekanizmat e vendosur nga MZhR për monitorimin e projekteve të financuara.....	10
2. Monitorimi dhe verifikimi i dokumentacionit lidhur me zbatimin e projekteve.....	10
3. Ekzaminimet fizike të projekteve dhe aseteve të financuara për mostrat e përzgjedhur.....	11
PJESA IV. KONKLuzionET	14
PJESA V. REKOMANDIMET	15
I PJESA VI. PËRGJIGJET NGA ENTITETI I AUDITUAR.....	17

Zyra Kombëtare e Auditimit, në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik kryen auditime vjetore financiare dhe pajtueshmërisë të detyrueshme me ligj dhe auditime të performancës.

ZKA përmes auditimeve ofron informacion cilësor mbi përdorimin e fondeve publike të cilat ndihmojnë entitetet e audituara të përmirësojnë sistemet e tyre të menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke rritur transparencën dhe llogaridhënien, parandalimin e korrupsionit dhe përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të fondeve publike. Njëkohësisht, kjo do të shtojë vlerë veprimtarisë së tyre operative dhe strategjike. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Përmes raporteve të auditimit, ne kemi ofruar një pamje të qartë se si qeveria dhe institucionet publike kanë menaxhuar me shpenzimet dhe të ardhurat, pasurinë publike dhe qeverisjen në nivel të vendit.

Kemi vlerësuar efektivitetin dhe efikasitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, përdorimin e drejtë të burimeve dhe sistemeve tjera në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal (MZHR).

Fushë me rëndësi të cilës Zyra Kombëtare e Auditimit i kushton vëmendje, është edhe ajo nëse MZHR ka vendosur dhe zbatuar mekanizma efektivë për monitorimin e projekteve të financuara përmes skemës së granteve për zhvillim rajonal, përmes shqyrtimit të raporteve të përfituesve dhe ekzaminimeve fizike në teren. Këto auditime kanë rol të rëndësishëm me ndikim që të rritet transparenca dhe efikasiteti në menaxhimit të granteve si dhe me qëllim që të rritet transparenca.

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA 4000). Auditimet e pajtueshmërisë të ndërmarra nga Zyra Kombëtare e Auditimit janë shqyrtime objektive dhe të besueshme që vlerësojnë nëse veprimet qeveritare, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat veprojnë në përputhje me autoritetet.

Auditorja e Përgjithshme ka vendosur në lidhje me përmbajtjen e raportin të auditimit “Monitorimi i zbatimit të Skemës së Granteve të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar”.

Përbërja e ekipit të auditimit:

Blerina Krasniqi, Drejtore e Auditimit;

Elvir Krasniqi, Udhëheqës i ekipit;

Aurora Morina, Anëtare i ekipit;

Selvete Foniqi, Anëtare e ekipit; dhe

Ardiana Selimaj, Anëtare i ekipit.

Shkurtesat

ZKA - Zyra Kombëtare e Auditimi

QRK - Qeveria e Republikës së Kosovës

MAP - Ministria e Administratës Publike

MZhR - Ministrin e Zhvillimit Rajonal

SNISA - Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit

PZHRB - Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar

PJESA I. PËRMBLEDHJA E PËRGJITHSHME

Zyra Kombëtare e Auditimit ka kryer auditimin e pajtueshmërisë me temën “Monitorimi i zbatimit të Skemës së Granteve të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar”. Objektivi i auditimit ishte të vlerësohej nëse MZhR ka vendosur dhe zbatuar mekanizma adekuatë për monitorimin dhe raportimin e projekteve të financuara, si dhe nëse projektet janë realizuar dhe dokumentuar në përputhje me kushtet e marrëveshjeve të financimit.

Auditimi përfshiu monitorimin e projekteve të financuara në kuadër të Skemës së Granteve për Zhvillim Rajonal për periudhën 2024–2025, duke përfshirë edhe marrëveshjet bazë të lidhura në vitet paraprake që lidhen me zbatimin e kësaj skeme. Subjekt i auditimit ishte Ministria e Zhvillimit Rajonal.

MZhR ka vendosur mekanizma për monitorimin e zbatimit të projekteve të financuara në kuadër të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar, duke përcaktuar përgjegjësitë dhe procedurat për monitorimin e projekteve, përfshirë monitorimin administrativ dhe vizitat në terren. Gjithashtu, janë përcaktuar kërkesat për raportim nga përfituesit, si dhe procedurat për verifikimin dhe dokumentimin e progresit të projekteve.

Megjithatë, auditimi ka identifikuar mangësi në procesin e monitorimit të projekteve të financuara. Dokumentacioni mbështetës i bashkëngjitur raporteve të monitorimit nuk ofronte në të gjitha rastet dëshmi të mjaftueshme dhe relevante për të mbështetur gjendjen e raportuar. Gjithashtu, gjatë ekzaminimeve fizike të projekteve të përzgjedhura u evidentuan raste të mosrespektimit të kushteve të marrëveshjeve të grantit lidhur me ruajtjen dhe përdorimin e aseteve të financuara. Deri në përfundim të auditimit, MZhR nuk kishte iniciuar procedurat për zbatimin e dispozitave kontraktuale, përfshirë procedurat për kthimin e mjeteve ose të aseteve të financuara.

Për të adresuar mangësitë e identifikuar, janë dhënë dy (2) rekomandime për Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, me qëllim përmirësimin e dokumentimit dhe besueshmërisë së procesit të monitorimit, forcimin e përcjelljes së respektimit të detyrimeve kontraktuale nga përfituesit, si dhe ndërmarrjen me kohë të masave të parapara në rastet kur evidentohen shkelje të kushteve të marrëveshjeve të grantit.

PJESA II. LËNDA E AUDITUAR DHE FUSHËVEPRIMI

I.1. TITULLI DHE ENTITETI I AUDITUAR

Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZhR) është institucion i administratës shtetërore, përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikave që lidhen me zhvillimin rajonal të balancuar, me qëllim të zvogëlimit të pabarazive ndërmjet rajoneve dhe promovimit të zhvillimit të qëndrueshëm socio-ekonomik.

Në kuadër të përgjegjësisë së saj, MZhR menaxhon Programin për Zhvillim Rajonal të Balancuar dhe zbaton skema të granteve për mbështetjen financiare të bizneseve dhe ndërmarrësve të rinj. Përmes këtyre skemave, Ministria financon projekte që synojnë zhvillimin ekonomik, krijimin e vendeve të punës, rritjen e kapaciteteve prodhuese dhe ofruese të shërbimeve, si dhe zhvillimin e qëndrueshëm rajonal.

Menaxhimi i skemave të granteve përfshin proceset e planifikimit dhe shpalljes së thirrjeve publike, vlerësimit dhe përzgjedhjes së përfituesve, lidhjes së marrëveshjeve të financimit, pagesës së mjeteve financiare, si dhe monitorimit të zbatimit të projekteve të financuara. Në kuadër të këtyre përgjegjësisë, MZhR është përgjegjëse për monitorimin e projekteve, verifikimin e respektimit të kushteve të përcaktuara në marrëveshjet e financimit dhe ndërmarrjen e masave përkatëse në rastet e identifikimit të devijimeve apo shkeljeve të kushteve të grantit.

Përgjegjësitë, procedurat dhe mekanizmat për menaxhimin dhe monitorimin e projekteve të financuara përcaktohen me Rregulloren (QRK) nr. 21/2024 për Menaxhimin e Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar, aktet nënligjore përkatëse, udhëzuesit dhe procedurat e brendshme të MZhR-së, si dhe marrëveshjet e financimit të lidhura ndërmjet Ministrisë dhe përfituesve të granteve.

Proceset e menaxhimit, monitorimit dhe raportimit të projekteve të financuara në kuadër të Skemës së Granteve për Zhvillim Rajonal të Balancuar zbatohen nga Departamenti për Planifikim dhe Koordinim të Zhvillimit Rajonal, në përputhje me përgjegjësitë e përcaktuara me aktet ligjore dhe nënligjore, procedurat e brendshme dhe marrëveshjet e financimit.

Për periudhën e audituar, financimet e realizuara nga ana e MZhR për Programin për Zhvillim Rajonal të Balancuar ishin 3,688,400€.

I.2. PERIUDHA E AUDITIMIT

Auditimi ka përfshirë periudhën kohore nga 01.01.2024 deri 31.12.2025, përfshirë edhe marrëveshjet bazë të lidhura në vitet e mëparshme.

I.3. ARSYESHMËRIA DHE BAZA LIGJORE PËR KRYERJEN E AUDITIMIT

Auditori i Përgjithshëm ka mandat kushtetues dhe ligjor për auditimin e programeve dhe projekteve të menaxhuara nga organizatat buxhetore dhe të financuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës. Në zbatim të këtij mandati, auditimi i monitorimit të zbatimit të projekteve të financuara përmes Skemës së Granteve të Programit për Zhvillim Rajonal të

Balancuar synon të vlerësojë nëse Ministria e Zhvillimit Rajonal ka vendosur dhe zbatuar mekanizma adekuatë dhe efektivë për monitorimin dhe raportimin e projekteve të financuara, si dhe nëse është siguruar respektimi i kushteve të marrëveshjeve të financimit.

Auditimi kryhet në bazë të paragrafit 2 të nenit 21 të Ligjit nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.

I.4. STANDARDET E PËRDORURA TË AUDITIMIT

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Në përputhje me ONISA-P-10 – Deklaratën e Meksikës mbi Pavarësinë e Institucioneve Supreme të Auditimit, SNISA 130 – Kodin e Etikës, SNISA 400 – Parimet e Auditimit të Pajtueshmërisë dhe SNISA 4000 – Standardin e Auditimit të Pajtueshmërisë, si dhe Manualin e Auditimit të Pajtueshmërisë të ZKA-së dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e pajtueshmërisë, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i audituar dhe zbaton kërkesat përkatëse etike gjatë kryerjes së auditimit. Dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për dhënien e konkluzioneve të auditimit.

I.5. PËRSHKRIMI I LËNDËS SË AUDITIMIT DHE FUSHËVEPRIMIT TË AUDITIMIT

Këtu përfshihen informacionet për tre proceset që ishin në kuadër të auditimit:

1. Mekanizmat e vendosur nga MZhR për monitorimin e projekteve të financuara;
2. Monitorimi dhe verifikimi i dokumentacionit lidhur me zbatimin e projekteve; dhe
3. Ekzaminimet fizike të projekteve dhe aseteve të financuara për mostrat e përzgjedhura.

Gjatë këtij auditimi nuk kemi pasur ndonjë kufizim që do të ndikonte në punën tonë audituese.

Në aspektin e procedurave, auditimi ka përfshirë vlerësimin e mekanizmave të vendosur nga MZhR për monitorimin e projekteve të financuara, shqyrtimin e dokumentacionit dhe raporteve të monitorimit, si dhe kryerjen e ekzaminimeve fizike për mostrat e përzgjedhura, me qëllim të verifikimit nëse projektet dhe asetet e financuara janë realizuar, përdorur dhe mirëmbajtur në përputhje me kushtet e marrëveshjeve të financimit dhe kërkesat përkatëse.

I.6. OBJEKTIVAT E AUDITIMIT

Të përcaktojë shkallën e pajtueshmërisë së vendimeve, veprimeve dhe proceseve të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal me kërkesat e kuadrit rregullator përkatës, akteve të brendshme dhe marrëveshjeve të financimit në fushën e audituar, përkatësisht:

1. Nëse MZhR ka vendosur dhe zbatuar mekanizma adekuatë dhe efektivë për monitorimin e projekteve të financuara në kuadër të Skemës së Granteve për Zhvillim Rajonal;

2. Nëse procesi i monitorimit dhe raportimit është dokumentuar në mënyrë të plotë, të saktë dhe të besueshme, në përputhje me kërkesat rregullative, procedurat në fuqi dhe marrëveshjet e financimit; dhe
3. Nëse aktivitetet dhe asetet e financuara, bazuar në ekzaminimet fizike të mostrave të përzgjedhura, janë realizuar, përdorur dhe mirëmbajtur në përputhje me kushtet e marrëveshjeve të financimit dhe raportimet e paraqitura nga përfituesit.

I.7. KRITERET E AUDITIMIT

Kriteret e auditimit janë përcaktuar bazuar në kuadrin ligjor dhe nënligjor, aktet e brendshme të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal dhe marrëveshjet e financimit, të cilat rregullojnë menaxhimin, zbatimin dhe monitorimin e projekteve të financuara në kuadër të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar.

Ligjet:

1. Ligji nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike;
2. Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me plotësimet dhe ndryshimet përkatëse.

Aktet nënligjore dhe dokumentet tjera relevante:

1. Rregullorja (QRK) nr. 21/2024 për Menaxhimin e Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar;
2. Udhëzimi Administrativ (MZhR) nr. 01/2018 për Kushtet dhe Kriteret e Përkrahjes së Bizneseve/Ndërmarrësve të Rinj nga Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar;
3. Udhëzuesi për Implementimin e Projekteve për Skemën e Granteve të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar;
4. Marrëveshjet e financimit të lidhura ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Rajonal dhe përfituesve të granteve;
5. Vendimet e MZhR-së për caktimin e zyrtarëve përgjegjës për monitorimin e implementimit të projekteve;
6. Procedurat, udhëzuesit dhe aktet e tjera të brendshme të MZhR-së që rregullojnë procesin e monitorimit dhe raportimit të projekteve të financuara; si dhe
7. Aktet e tjera ligjore dhe nënligjore relevante për menaxhimin, monitorimin dhe përdorimin e fondeve publike në kuadër të skemës së audituar.

PJESA III. GJETJET

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka identifikuar mangësi në procesin e monitorimit të projekteve të financuara në kuadër të Skemës së Granteve të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar. Mangësitë e identifikuara lidhen me dokumentimin e gjendjes së projekteve në raportet e monitorimit, si dhe me mosidentifikimin e shkeljeve të kushteve të marrëveshjeve të grantit dhe mosndërmarrjen e masave përkatëse kontraktuale.

Gjetjet e auditimit bazohen në shqyrtimin e raporteve të monitorimit, marrëveshjeve të grantit dhe dokumentacionit mbështetës përkatës, si dhe në rezultatet e ekzaminimeve fizike të projekteve dhe aseteve të financuara të përzgjedhura për testim. Në vijim paraqiten çështjet e identifikuara gjatë auditimit.

1. Mekanizmat e vendosur nga MZhR për monitorimin e projekteve të financuara

Kriteret: Kriteret e auditimit lidhur me mekanizmat e vendosur nga Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZhR) për monitorimin e projekteve të financuara burojnë nga Rregullorja (QRK) Nr. 21/2024 për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, Udhëzimi Administrativ (MZhR) Nr. 01/2018 për zbatimin e Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar, marrëveshjet e financimit të projekteve, si dhe aktet e tjera relevante që rregullojnë monitorimin dhe raportimin e projekteve të financuara.

Gjendja e konstatuar

Bazuar në auditimin e kryer, është konstatuar se:

- a) MZhR ka vendosur mekanizma për monitorimin e zbatimit të projekteve të financuara në kuadër të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar;
- b) Janë përcaktuar përgjegjësitë dhe procedurat për monitorimin e projekteve, përfshirë monitorimin administrativ dhe vizitat në terren;
- c) Janë përcaktuar kërkesat për raportim nga përfituesit, si dhe procedurat për verifikimin dhe dokumentimin e progresit të projekteve.

Në përgjithësi, MZhR ka vendosur mekanizmat bazë për monitorimin e projekteve të financuara. Megjithatë, efektiviteti dhe zbatimi i këtyre mekanizmave në praktikë, përfshirë saktësinë e raportimit, verifikimin e gjendjes faktike dhe identifikimin e shkeljeve të kushteve të financimit, janë trajtuar në proceset përkatëse të auditimit.

2. Monitorimi dhe verifikimi i dokumentacionit lidhur me zbatimin e projekteve

Në fushën e audituar "Monitorimi dhe verifikimi i dokumentacionit lidhur me zbatimin e projekteve", ekipi i auditimit ka ekzaminuar 30 mostra të projekteve të financuara në kuadër të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar. Gjatë ekzaminimit është konstatuar si vijon:

- a) Për mostrat e testuara, përfituesit kishin dorëzuar raportet dhe dokumentacionin mbështetës të kërkuar në përputhje me marrëveshjet e financimit dhe kërkesat përkatëse;
- b) MZhR kishte kryer shqyrtimin administrativ të dokumentacionit të dorëzuar nga përfituesit, duke verifikuar përmbushjen e kërkesave të përcaktuara për raportim dhe dokumentim të projekteve; dhe
- c) Dokumentacioni i projekteve të testuara përmbante raportet e monitorimit, procesverbalet, fotografitë dhe dokumentet e tjera mbështetëse për dokumentimin e aktiviteteve monitoruese.

Megjithatë, nga shqyrtimi dhe krahasimi i raporteve të monitorimit me dokumentacionin mbështetës të projekteve, në tri raste u evidentuan mangësi në dokumentimin e gjendjes së projekteve gjatë monitorimit. Dokumentacioni i bashkëngjitur raporteve të monitorimit nuk ofronte dëshmi të mjaftueshme dhe relevante për të mbështetur gjendjen e raportuar, pasi ishin përdorur fotografi të realizuara në faza të mëhershme ose fotografi të pajisjeve që nuk korrespondonin me pajisjet e financuara me grant.

Mangësitë e identifikuara në dokumentimin e gjendjes së projekteve në raportet e monitorimit trajtohen më hollësisht në vijim.

Çështja 1: Mangësi në dokumentimin e gjendjes së projekteve në raportet e monitorimit

Kriteri

Sipas nenit 30, paragrafi 1 të Rregullores (QRK) nr. 21/2024 për Menaxhimin e Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar, Ministria, përkatësisht Departamenti për Zhvillim Rajonal, është përgjegjës për menaxhimin, monitorimin dhe vlerësimin e projekteve. Po ashtu, sipas paragrafit 2 të të njëjtit nen, Ministria emëron zyrtarin përgjegjës ose ekipin përgjegjës për secilën kontratë me qëllim të monitorimit të zbatimit të projektit dhe vlerësimit të përmbushjes së objektivave dhe arritjes së rezultateve të parapara.

Gjithashtu, sipas Vendimit nr. 41, datë 02.02.2026, për caktimin e zyrtarëve përgjegjës për monitorimin e implementimit të projekteve, zyrtarët monitorues obligohen të monitorojnë implementimin e projekteve në përputhje me Rregulloren nr. 21/2024, marrëveshjet e financimit dhe Udhëzuesin për Implementimin e Projekteve për Skemën e Granteve PZHRB 2024. Raportet e monitorimit duhet të pasqyrojnë në mënyrë të saktë dhe të plotë gjendjen faktike të konstatuar gjatë vizitave monitoruese.

Gjendja

Zyrtarët përgjegjës për monitorimin e projekteve kishin hartuar raportet përkatëse të monitorimit për përfituesit e granteve, në të cilat ishte raportuar se projektet po zbatoheshin në përputhje me marrëveshjet e grantit dhe se gjendja e tyre ishte e rregullt.

Megjithatë, nga shqyrtimi dhe krahasimi i dokumentacionit të monitorimit me dokumentacionin mbështetës të projekteve, u evidentuan mangësi në dokumentimin e gjendjes së projekteve në raportet e monitorimit. Në një rast, raportit të monitorimit i ishin bashkëngjitur fotografi të realizuara në fazën e pranimi fillestar të pajisjeve, në vend të fotografive të realizuara gjatë vizitës monitoruese. Në dy raste të tjera, raportit të monitorimit i ishin bashkëngjitur fotografi të pajisjeve që nuk korrespondonin me pajisjet e financuara me grant. Gjithashtu, në njërin prej këtyre rasteve, fotografitë e bashkëngjitura paraqisnin pajisje ende me ambalazhin mbrojtës, ndërkohë që në raport ishte konstatuar se ato ishin funksionale dhe në përdorim.

Këto mangësi tregojnë se dokumentacioni mbështetës i bashkëngjitur raporteve të monitorimit nuk ofron dëshmi të mjaftueshme dhe relevante për të mbështetur gjendjen e raportuar gjatë monitorimit.

Shkaku

Kjo kishte ndodhur për shkak të moszbatimit të plotë të përgjegjësi nga zyrtarët monitorues për dokumentimin e gjendjes së projekteve gjatë vizitave monitoruese dhe sigurimin e dëshmive të mjaftueshme dhe relevante për të mbështetur konstatimet e paraqitura në raportet e monitorimit.

Ndikimi

Mangësitë në dokumentimin e gjendjes së projekteve zvogëlojnë besueshmërinë e raporteve të monitorimit dhe nuk ofrojnë siguri të mjaftueshme se informacioni i raportuar mbështetet në gjendjen e konstatuar gjatë vizitave monitoruese. Si rrjedhojë, kufizohet mundësia e MZHR-së për të vlerësuar në mënyrë të besueshme zbatimin e projekteve dhe respektimin e kushteve të marrëveshjeve të grantit.

Rekomandimi

Ministri duhet të sigurojë që raportet e monitorimit të mbështeten me dokumentacion të plotë, aktual dhe relevant, i cili dëshmon gjendjen e konstatuar gjatë vizitave monitoruese, përfshirë fotografi të realizuara gjatë këtyre vizitave. Dokumentacioni mbështetës duhet të korrespondojë me asetet e financuara dhe me konstatimet e paraqitura në raport, në mënyrë që të sigurohet saktësia dhe besueshmëria e informacionit të raportuar.

3. Ekzaminimet fizike të projekteve dhe aseteve të financuara

Ekzaminimet fizike të projekteve dhe aseteve të financuara rregullohen me dispozitat e Udhëzimit Administrativ (MZHR) Nr. 01/2018 për zbatimin e Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar, Rregullores (QRK) Nr. 21/2024, si dhe me marrëveshjet e financimit, të cilat kërkojnë që:

- MZHR të realizojë vizita monitoruese në terren për të verifikuar progresin dhe zbatimin e projekteve të financuara;
- gjatë vizitave në terren të verifikohet përputhshmëria e aseteve të financuara me marrëveshjen e financimit dhe dokumentacionin mbështetës;
- rezultatet e ekzaminimeve fizike të dokumentohen përmes raporteve të monitorimit, procesverbaleve, fotografive dhe dokumenteve të tjera mbështetëse; dhe

- në rast të identifikimit të devijimeve ose mosrespektimit të kushteve të marrëveshjes, MZHR të ndërmarrë masat e parapara në aktet përkatëse dhe në marrëveshjet e financimit.

Projektet dhe asetet e përfshira në mostrën e auditimit janë ekzaminuar fizikisht për të vlerësuar respektimin e kushteve të marrëveshjeve të financimit lidhur me ruajtjen dhe përdorimin e aseteve të financuara.

Gjatë ekzaminimeve fizike të projekteve dhe aseteve të përzgjedhura, u evidentuan raste të mosrespektimit të detyrimeve kontraktuale nga përfituesit lidhur me ruajtjen dhe përdorimin e aseteve të financuara. Mangësitë e identifikuar nga ekzaminimet fizike trajtohet më hollësisht në vijim.

Çështja 2: Shkelje të kushteve të marrëveshjeve të grantit dhe mosndërmarrja e masave kontraktuale

Kriteri

Sipas nenit 5, paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ (MZHR) nr. 01/2018 për Kushtet dhe Kriteret e Përkrahjes së Bizneseve/Ndërmarrësve të Rinj nga Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar, të gjithë përfituesit e projekteve obligohen t'i mirëmbajnë investimet sipas projektit të miratuar për një periudhë dyvjeçare pas realizimit të projektit.

Po ashtu, sipas nenit 3, paragrafi 4 të marrëveshjeve të grantit, përfituesit zotohen që gjatë kësaj periudhe të mos i tjetërsojnë, shesin, japin me qira apo huazojnë makineritë dhe pajisjet e financuara nga granti.

Ndërsa, sipas nenit 7, paragrafi 2 të marrëveshjeve të grantit, nëse MZHR konstaton se investimi publik nuk është përdorur sipas qëllimit të projektit ose është tjetërsuar, ajo ka të drejtë dhe obligim të kërkojë kthimin e mjeteve të financuara dhe të ndërmarrë veprimet e nevojshme ligjore.

Gjendja

Gjatë ekzaminimeve fizike të tri projekteve të financuara me grante, u konstatua se përfituesit nuk kishin respektuar detyrimet kontraktuale lidhur me ruajtjen dhe përdorimin e aseteve të financuara, si në vijim:

- Në një projekt të financuar me grant në vlerë prej 28,000€ për blerjen e pajisjeve për zdrukthëtari, mungonte makineria për prerjen e dërrasave të ivericës në vlerë prej 15,000€;
- Në një projekt tjetër të financuar me grant në vlerë prej 30,000€ për blerjen e pajisjeve për veprimtari furrtarie, mungonte mikseri për përzierjen e brumit në vlerë prej 9,000€;
- Në një projekt të tretë të financuar me grant në vlerë prej 14,990€ për blerjen e pajisjeve në fushën e shërbimeve të pastrimit, mungonin tetë nga njëmbëdhjetë pajisjet e

financuara, në vlerë të përgjithshme prej 11,594€, përfshirë makinat për pastrimin e dysHEMEVE dhe fshesat thithëse për pastrimin e pluhurit.

Këto raste përbënin shkelje të kushteve të marrëveshjeve të grantit lidhur me ruajtjen dhe përdorimin e aseteve të financuara. Deri në përfundim të auditimit, MZHR nuk kishte iniciuar procedurat për zbatimin e dispozitave kontraktuale, përfshirë kërkimin për kthimin e mjeteve ose të aseteve të financuara, si dhe ndërmarrjen e masave të tjera të parapara në marrëveshjet e grantit.

Shkaku

Kjo kishte ndodhur për shkak të mangësive në verifikimin e respektimit të detyrimeve kontraktuale nga përfituesit dhe në përcjelljen e përmbushjes së këtyre detyrimeve gjatë periudhës monitoruese.

Ndikimi

Mangësitë në përcjelljen e respektimit të detyrimeve kontraktuale dhe mosndërmarrja e masave përkatëse dobësojnë mekanizmat e kontrollit mbi përdorimin e fondeve publike dhe efektivitetin e zbatimit të marrëveshjeve të grantit. Si rrjedhojë, rritet rreziku që asetet e financuara të tjetërsohen ose të përdoren në kundërshtim me qëllimin për të cilin janë financiar, si dhe vështirësohet ndërmarrja e kohë e masave për kthimin e mjeteve ose aseteve të financuara.

Rekomandimi

Ministri duhet të sigurojë që, në çdo rast kur evidentohen shkelje të kushteve të marrëveshjeve të grantit, të ndërmerren pa vonesë procedurat për zbatimin e dispozitave kontraktuale dhe ligjore. Kjo duhet të përfshijë kërkimin për kthimin e mjeteve ose të aseteve të financuara, sipas rastit, si dhe ndërmarrjen e masave të tjera të parapara në marrëveshjet e grantit, me qëllim mbrojtjen e fondeve publike dhe sigurimin e zbatimit të plotë të kushteve të detyrimeve kontraktuale.

PJESA IV. KONKLuzionet

Bazuar në gjetjet e auditimit, konkludojmë se Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZhR) ka vendosur mekanizma për monitorimin e projekteve të financuara në kuadër të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar dhe ka zhvilluar aktivitete monitoruese. Megjithatë, zbatimi i këtyre mekanizmave nuk ka qenë plotësisht efektiv për të siguruar monitorim të besueshëm, raportim objektiv dhe mbikëqyrje të vazhdueshme të projekteve.

Auditimi konstatoi se dokumentacioni mbështetës i bashkëngjitur raporteve të monitorimit nuk ofronte në të gjitha rastet dëshmi të mjaftueshme dhe relevante për të mbështetur gjendjen e raportuar. Përdorimi i fotografive të realizuara në faza të mëhershme, si dhe i fotografive të pajisjeve që nuk korrespondojnë me ato të financuara me grant, zvogëlon besueshmërinë e informacionit të raportuar dhe kufizon mundësinë e MZhR-së për të vlerësuar në mënyrë të besueshme zbatimin e projekteve dhe respektimin e kushteve të marrëveshjeve të grantit.

Gjithashtu, gjatë ekzaminimeve fizike të kryera nga auditimi u evidentuan raste të mosrespektimit të detyrimeve kontraktuale lidhur me ruajtjen dhe përdorimin e aseteve të financuara. Deri në përfundim të auditimit, MZhR nuk kishte iniciuar procedurat për zbatimin e dispozitave kontraktuale dhe ligjore për adresimin e këtyre rasteve. Kjo rrit rrezikun që asetet e financuara të tjetërsohen ose të përdoren në kundërshtim me qëllimin për të cilin janë financuar dhe vështirëson ndërmarrjen me kohë të masave për kthimin e mjeteve ose aseteve të financuara, sipas rastit.

Përmirësimi i dokumentimit të procesit të monitorimit, forcimi i përcjelljes së respektimit të detyrimeve kontraktuale nga përfituesit dhe ndërmarrja me kohë e masave të parapara ndaj shkeljeve të evidentuara do të kontribuonin në rritjen e besueshmërisë dhe efektivitetit të procesit të monitorimit, forcimin e llogaridhënies dhe mbrojtjen e fondeve publike.

PJESA V. REKOMANDIMET

Si rezultat i auditimit të pajtueshmërisë, rekomandimet e mëposhtme i adresohen Ministrit të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal.

Rekomandimet për Ministrin

1. Të sigurojë që raportet e monitorimit të mbështeten me dokumentacion të plotë, aktual dhe relevant, i cili dëshmon gjendjen e konstatuar gjatë vizitave monitoruese, përfshirë fotografi të realizuara gjatë këtyre vizitave. Dokumentacioni mbështetës duhet të korrespondojë me asetet e financuara dhe me konstatimet e paraqitura në raport, në mënyrë që të sigurohet saktësia dhe besueshmëria e informacionit të raportuar;
2. Të sigurojë përcjelljen dhe verifikimin e respektimit të detyrimeve kontraktuale nga përfituesit gjatë periudhës monitoruese dhe, në çdo rast kur evidentohen shkelje të kushteve të marrëveshjeve të grantit, të ndërmerren pa vonesë masat kontraktuale dhe ligjore të parapara, përfshirë procedurat për kthimin e mjeteve ose të aseteve të financuara, sipas rastit.

I PJESA VI. PËRGJIGJET NGA ENTITETI I AUDITUAR



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pajtueshmërisë “Monitorimi i zbatimit të Skemës së Granteve të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar” për periudhën 2024-2025 (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Rasim Demiri, Ministër i Zhvillimit Rajonal

Prishtinë, 06.08.2026



